

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegj i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi, Tonka Berishaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.L. nga fsh. ... K.Ferizaj, për shkak të veprës penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.7 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit M.L. av. L.Q.-I., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.115/2018 datë 21.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 03.01.2019 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit M.L., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.115/2018 datë 21.09.2018 **vërtetohet**.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.115/2018 datë 21.09.2018, të akuzuarin M.L. e ka shpallur fajtorë për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.7 të KPRK-së, për çka e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim do ta vuaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë dhe dënim me gjobë në shumë prej 200(dyqindtë) euro të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë. Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format e parapara me nenin 46 par.3 të KPRK-së, dënimi i caktuar me gjobë do të shndërrohet në dënim burgu, ashtu që për çdo 20 euro do të llogaritet një ditë burgu. Konform nenit 281 par.2 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme: substanca narkotike e llojit marihuan me peshë prej 0.32 gram dhe me peshë prej 0.38 gram, në peshë të përgjithshme 0.70 gram. Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 euro, si dhe të paguaj shumën prej 50 euro në Fondin për Kompensimin e Viktimave të dhunës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

-Mbrojtësja e të akuzuarit M. L. av. L.Q.-I., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoj ankesën. aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoj sa i përket sanksionit penal dhe te akuzuarit ti shqiptoj vërejtje gjyqësore apo te ndryshohet ashtu që dënimi me burgim te zëvendësohet në dënim me kusht.

Gjykata e Apelit e caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, në të cilën nuk prezantoi Prokurori i Apelit dhe i akuzuari M.L. edhe pse te ftuar me rregull për kohën e mbajtjes se seancës, kurse prezent ishte mbrojtësja e tij av. L.Q.- I, e cila mbeti pranë ankesës se parashtruar me shkrim.

- Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.550/2018 të dt. 11.12.2018 ka propozuar që ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit M.L. av. L.Q.I. të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa është e pa bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtëses se te akuzuarit M.L. av. L.Q.-I. lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa është e pa bazuar. Në ankesën e mbrojtëses nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që do të ndikonte në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit. Mbrojtja në ankesë thekson pasi që i akuzuari M.L. që në shqyrtimin fillestarë është treguar kooperativ para gjykatës së shkallës së parë dhe real ne raport me pranimin e fajësisë për veprën e cila i ngarkohet, i njëjti ka kërkuar falje për veprimet e tija të pa matura, me sinqeritet ka premtuar para asaj gjykate se veprimet e njëjta apo te ngjashme nuk do ti përsërisë më, fakti se i njëjti është në pritje të një pune të mirë pasi që edhe më herët ishte në marrëdhënie pune, po ashtu ka një familje të arsimuar e cila sigurisht se do të ndikoj në vetëdijesimin dhe socializmin e tij njehe rit për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, si dhe bazuar ne praktikat gjyqësore se çfarë dënime po shqiptojnë gjykatat e vendit tonë kur ato po gjykojnë figurat e njohura publike ku në shumicën e rasteve prej tyre marrin dënime me kusht, gjykata e shkallës së dytë në rastin konkret duhet të shikojë nëse ekzistojnë kushte ligjore që ndaj te mbrojturit tim te shqiptohet vërejtje gjyqësore ose ne rast tjetër dënim me kusht.

Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat drejtë i ka vlerësuar edhe Gjykata e shkallës së parë, dhe atë rrethanën veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë për këtë veprë penale, se është penduar thelle, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla penale, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, është i moshës relativisht të re, i gjendjes së dobët ekonomike, sasinë e vogël të substancës narkotike dhe llojin e saj (marihuan) ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor, gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin nën minimumin e paraparë ligjor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
PAKR.nr.580/18, më 03.01.2019

Procesmbajtës,  
Eroll Gashi

Kryetare e kolegjit- gjyqtarja  
1. Mejreme Memaj\_\_\_\_\_

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi\_\_\_\_\_

3. Tonka Berishaj\_\_\_\_\_